

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIMAL  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 550/prot.

Urë Vajgurore, më 05.03.2024

VENDIM

Nr. 15 Datë 05.03.2024

**“Mbi miratimin për prishjen e godinës së shkollës në Fshatin Polizhan me Nr. Pasurie 912/17, ZK 3957”.**

Këshilli i Bashkisë Dimal, në mbledhjen e tij të datës 05.03.2024 mbi bazën e materialit të paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Të Territorit, dhe në mbështetje të Ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “ Për Vetëqeversjen Vendore” i ndryshuar, VKM Nr.563 datë 22.08.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme Publike, Shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Poshnje, Të Qarkut të Beratit VKM Nr.408 “Për miratimin e Rregullorës së Zhvillimit të Territorit” i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr 30 datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik , Udhëzimi Nr 20 datë 17.11.2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr 30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Sektorin Publik”.

VENDOSI :

**Me 16 vota PRO, nga 16 Këshilltarë prezentë:**

- 1.Të miratojë prishjen e detyruar të godinës së vjetër të shkollës në fshatin Polizhan me nr pasurie 912/17, ZK 3957, e ndërtuar në vitin 1992 me vlerë fillestare 3,800,000 lekë.
- 2.Heqjen nga lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të komunës Poshnje, qarku Berat me VKM Nr.563, datë 22.08.2012.
- 3.Toka (trualli) i liruar nga prishja e godinës përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimit të shërbejë për ndërtimin e një objekti tjetër shtetëror.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak të publikojë vendimin në faqen zyrtare të Këshillit Bashkiak Dimal.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të Ligjit 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore “, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**AVDULLA SALILLARI**